



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
KRYETARI  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shijak, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**“Rikonstruksion i rrugeve ne Fshatin Karrec te Nj.Ad Maminas ”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Punë ndërtimi - 45000000-7 .**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**31.064.499,28** (tridhjetënjë milion e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë presje njëzetë e tetë ) lekë pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shijak, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit ,Shtojce 2

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 të DST).

c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

d. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

#### **Sipas Shtojcës 7 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për*

*auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të , në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **31.064.499,28** (tridhjetënjëmilion e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë presje njëzetë e tetë ) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore , në përputhje me përcaktimet e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar , në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shijak, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

### **Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

#### **1.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 15.532.249,5 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e dyzetë e nëntë presje pesë ) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit të kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 62.128.998 (gjshtëdhjetë e dy milion e njëqind e njëzetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë ) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

**1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b)** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
  - Fatura tatimore perkatese.

**1.3** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.3.1 Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: kontratën baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontraten e nenkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nenkontraktor

**Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 15.532.249,5 (pesëmbëdhjetë million e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e dyzetë e nëntë presje pesë lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 62.128.998 (gjshtëdhjetë e dy million e njëqind e njëzetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë ) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur

vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”** .

## **2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

### **PUNIME TË PËRGGJITHSHME NDËRTIMI**

- N.P-1 A (Punime gjurmimi në tokë)
- N.P-2 A (Ndërtime civile e industrial)
- N.P-4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale).

### **PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

- N.S-18 A (Punime topogjeodezike) Arg: për zera të preventivit punimet e piketimit dhe punimet topografike si piketimin e segmentit rrugor ).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategorite e licenses “N.P dhe N.S” të percaktuara ne piken 2 te kriterëve te vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik jane hartuar në përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gërmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës. Përcaktimi i nënkategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave te secilit volum pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<b>NP-1</b>	<b>Punime gërmimi në tokë</b> Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	Zërat e preventivit .3.89a , 3.98 b , punime gërmimi dhe transport	A	<b>21-50 milionë lekë</b>  Vlera e parashikuar në preventiv rreth 627691,551 lekë
<b>NP-2</b>	<b>Ndërtime civile e industrial</b> Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të	Zërat e preventivit 2.2112, 3.337, 3.340, 3.365	A	<b>21-50 milionë lekë</b>  Vlera e parashikuar në preventiv



	ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje			rreth 2844254,88 lekë
<b>N.P-4</b>	<b>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale</b> Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderrur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore	Zërat e preventivit 3.210, 3.212/b ,	A	<b>21-50 milionë lekë</b>  Vlera e parashikuar në preventiv rreth 6932819,13 lekë
<b>N.S-18 A</b>	<b>Punime topogjeodezike</b> Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.	Zërat e preventivit Punime topografike	A	<b>0-20 milionë lekë</b>  Vlera e parashikuar në preventiv rreth lekë

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën *e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit*, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit).

*Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektroteknik, mjedisi, hidroteknik, topograf, gjeolog, arkitekt është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 30 punonjës të vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit).*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 55 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 6 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave (Qershor, Korrik, Gusht, 2024), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Licencën profesionale dhe Cv.
- Listpagesën shoqërisë e tre muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave (Qershor, Korrik, Gusht 2024).

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

6. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
  - a) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për 1 Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjesi të pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

7. Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- 2 karpentiere
- 28 puntore te thjeshte
- 2 Punonjes eskavatoriste
- 2 Punonjes buldozeriste
- 2 Punonjes automakiniste

- Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Për specialistët e kërkuar më sipër të paraqiten Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale ose çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tyre si dhe kontrata individuale e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, të paktën, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave

Per punetoret e thjeshte te paraqitet kontrate individuale e punes e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, të paktën, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e sipercituar emrin, profilin e punes.

Për Manovratore/automakiniste/ shofer të paraqitet kontrata e punes dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR . Ne rastin kur punonjesit e mesiperm jane te kontraktuar me kontrate pune respektivisht per mjetet e marra me qira , nuk kerkohet te figurojne ne listpagesat e shoqerise.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe*

*fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Për punonjësit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- leje drejtimi, certifikate e aftësi profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet

profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjermimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist** ( per mjete me goma ose me zinxhire) ;
  - b) makineri gjermimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: buldozere, traktore, skreper, greidera (nivelues), rulo vibruës, shtruese asfalto betoni, sonda shpimi vetelevizese, manovratorëve u jepet dëshmi per **Buldozeriste** (me goma ose me zinxhire)
  - c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**.
8. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj. *(Ky dokument duhet të paraqitet në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit në SPE).*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar).

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon:

- a.1 ( nje ) Impian prodhimi Asfalti
- a. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të asfaltit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) .Në rast se impianti i prodhimit të betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerash/bashkëpunimit e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve .

OE duhet të paraqesë kartat teknologjike për impiantin e prodhimit të asfaltit dhe vërtetimin teknik të lëshuar sipas ligjit nr 71/2014 , date 10.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 8450 date 24.02.1999 “”Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” I ndryshuar.

Për impiantin e prodhimit të betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) .Në rast se impianti i prodhimit të betonit, është me qera ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerash/bashkëpunimit e vlefshme për periudhën të zbatimit të punimeve .

**Argumentim:** *Per garantimin e cilësisë dhe furnizimit në kohë sipas të gjitha specifikimeve që janë kërkuar nga autoriteti kontraktor*

**10.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencë të kategorisë III.1 B bazuar në pikën 8 dhe 9 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar, i lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 8 dhe 9 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Licensën e kërkuar , është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Licensa e kërkuara është në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

**10.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të kategorisë III.2.B Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”. bazuar në pikën 8 dhe 9 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar, i lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

*Argumentimi: Mbeshtetur në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin 16/2024 , nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”. Nga punimet e ndertimit do të gjenerohen mbetje që duhen transportuar në venddepozitim të caktuar nga AK.*

**12.** Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.

**Argumentim:** *Kjo kërkesë është bërë në përputhje me nenin 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: „Autoriteti/enti*



*kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”-“d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

**13.** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

**14.**

Nr	Lloji i Makinerive		Pronësia	Sasia
1	Ekskavator me zinxhir	0.25m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Asfaltoshtrues		në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Autobitumatriçe		në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Rrul vibrues me kompresor		në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Betoniere 500 l		në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Elektrosaldatrice		në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Gazogjen		në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Trapano		në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Autovinc		në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Grejder i targuar		në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Kamion veteshkarkues min 10 ton		në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Autobot uji		në pronësi ose me qira	Copë 1

13	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Autofshese	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Minifadrome me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa për mjete të marra me qera/kontrata bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ bashkëpunimit.
- **Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrata bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ Kontrata Bashkëpunimi.
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerës, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shijak.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të detyrës së projektimit. Mjetet janë përcaktuar sipas nevojës së zbatimit të projektit

*Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).*

*Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përcakton në ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Njesia e prokurimit**

Teuta Plaku / personi përgjegjës  
Ruzhdi Shehi anëtar / specialist i fushës  
Helidon Kalleshi anëtar /shëf sektori shërbimeve